

**MEMORANDUM MIRKUPTIMI
PËR DHURIMIN E AUTOMJETIT OPEL ZAFIRA, LIMOUSINE**

I lidhur në Gjakovë me datë: 20.09.2018, në mes të palëve :

1. Sefer Bilall Gashi, me numër personal 100786618 nga Gjakova në tekstin vijues: Dhuratëdhënësi.

2. Komuna e Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini në tekstin vijues: Dhuratëmarrësi.

Neni 1

Lëndë e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është dhurimi i Automjetit OPEL Zafira A22TD, Limousine me targa FR 343832.

Neni 2

2.1 Duke qenë i motivuar për ofrimin e ndihmës për bamirësi, e me qëllim të arritjes së të mirës së përgjithshme, dhuratëdhënësi ka vendosur që me vullnetin e tij dhe pa asnjë kushtëzim, t'ia dhurojë Komunës së Gjakovës Automjetin OPEL Zafira A22TD, Limousine me targa FR 343832.

2.2 Dhuratëdhënësi deklaron se objekti i dhuratës nuk është i ngarkuar me ndonjë barrë dhe i pranon të gjitha përgjegjësitë lidhur me objektin e dhuratës.

2.3 Automjeti OPEL Zafira A22TD, Limousine me targa FR 343832 i dhuruar nga dhuratëdhënësi do t' i epet Komunës së Gjakovës si dhuratë.

Neni 3

3.1 Dhuratëmarrësi e pranon dhuratën nga dhuruesi dhe e konsideron këtë veprim si akt bamirësie, në dobi të Komunës së Gjakovës.

3.2 Dhuratëmarrësi obligohet që dhuratën e pranuar nga dhuruesi, t' a evidentojë në regjistrin e dhuratave dhe objekti i kësaj dhurate do të konsiderohet aset i Komunës së Gjakovës.

Neni 4

Ky Memorandum Mirëkuptimi hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe i njëjti nuk mund të kontestohet pas kryerjes së aktit të pranim – dorëzimit të dhuratës.

PALËT

Sefer Gashi

